



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



UDHËZUES PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
UDHËZUESIT PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGISË
ELEKTRIKE NË KOSOVË, DHE I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR
ME DATË 13 QERSHOR 2018

Prishtinë, 30 tetor 2018



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafin 1, nënparagrafin 1.7, Nenin 25, Neni 26, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05-L-084), në seancën e mbajtur me datë 30 tetor 2018 miratoi:

UDHËZUESIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZUESIT PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të datës 18 janar 2017 dhe plotësim ndryshimet të datës 13 qershor 2018 të miratuara nga Bordi i Rregullatorit.

Neni 2 Derregullimi i çmimit për konsumatorët fundor

Neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin në vijim:

- 1.3. "Konsumatorët komercial në nivelet e tension 10kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2020".

Neni 3 Dispozitat kalimtare

Dispozitat tjera të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike të datës 17 janar 2017 dhe plotësim ndryshimet të datës 13 qershor 2018 të miratuara nga Bordi i Rregullatorit, mbeten të pandryshuara dhe do të zbatohen në tërësi.

Neni 4 Plotësimi i kushteve teknike

Rregullatori do të ndërmarr veprime konkrete ligjore për plotësimin e kushteve teknike dhe ligjore që ndërlidhet me çështjet e përshkruara në udhëzuesin për liberalizimin e tregut.

Neni 5 Ndryshimi

1. Rregullatori ka të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj dispozitat e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut.



2. Procedurat për ndryshim ose modifikim e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut do të jenë të njëjta si për miratimin e tij.

Neni 6
Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut, Bordi do të nxjerr informacione shpjeguese.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Plotësim ndryshimet e Udhëzuesit për liberalizimin e tregut hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar